

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**
**OLIMPIADA KOMBËTARE E HISTORISË
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË**

Faza e tretë

4 prill 2026

Udhëzime për nxënësin:

- Olimpiada fillon në orën 10:00 dhe mbaron në orën 13:00.
- Testi përmban 5 pyetje.
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5
		11 pikë	9 pikë	10 pikë	10 pikë
Pikët e fituara					

Totali i pikëve të fituara

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....

2.....

1. Në shekujt IV dhe XVI, tensionet fetare dhe nevojat politike detyruan sunduesit të nxirrnin edikte për të menaxhuar shoqëritë e tyre. Edikti i Milanit (313) i Perandorit Konstandini i Madh garantoi lirinë fetare për të krishterët në Perandorinë Romake, duke vendosur një precedent për marrëdhëniet ndërmjet Kishës dhe pushtetit laik. Në mënyrë të ngjashme, Edikti i Nantës (1598) i Mbretit Henri IV të Francës synonte të zgjidhte konfliktet midis katolikëve dhe hygenotëve protestantë, duke garantuar disa liri fetare dhe duke ruajtur stabilitetin politik të Francës pas një periudhe të gjatë luftërash fetare. Në të dy rastet, ediktet reflektuan një tension midis qëllimeve shpirtërore dhe interesave politike.

a) Paqe dhe tolerancë: Si kontribuoi secili edikt në sigurimin e paqes dhe lirisë fetare për popullsinë e kohës? Evidentoni dy pika të përbashkëta midis këtyre dy edikteve. **4 pikë**

– **Edikti i Milanit (313)**, i nxjerrë nga perandori Konstandini i Madh, përfaqësoi një kthesë të rëndësishme në historinë fetare të Perandoria Romake. Ky edikt garantonte lirinë fetare për të gjithë qytetarët, duke i dhënë fund një periudhe të gjatë persekutimesh ndaj të krishterëve. Për herë të parë, të krishterët u lejuan të praktikonin hapur besimin e tyre pa frikë nga ndëshkimi shtetëror, të ndërtonin vende kulti dhe të organizonin jetën e tyre fetare në mënyrë të ligjshme.

Përveç kësaj, edikti parashikonte edhe rikthimin e pronave që u ishin konfiskuar të krishterëve gjatë persekutimeve, gjë që ndihmoi në rivendosjen e drejtësisë dhe besimit ndaj autoritetit shtetëror. Kjo politikë nuk favorizonte vetëm një fe, por synonte të krijonte tolerancë fetare dhe bashkëjetesë midis besimeve të ndryshme brenda perandorisë.

Si rezultat, Edikti i Milanit kontribuoi ndjeshëm në uljen e tensioneve fetare dhe në stabilizimin e jetës shoqërore. Ai forcoi autoritetin e perandorit duke e paraqitur atë si garant të paqes dhe të drejtave të qytetarëve, ndërsa krijoi një model të ri marrëdhëniesh midis shtetit dhe fesë, ku toleranca dhe bashkëjetesa u bënë elementë kyç për ruajtjen e unitetit politik dhe shoqëror.

– **Edikti i Nantës (1598)**: Mbreti Henri IV shpalli Ediktin e Nantës si një përpjekje për të vendosur paqe pas dekadash luftërash civile midis katolikëve dhe hygenotëve protestantë në Francë. Ky edikt i garantonte hygenotëve lirinë për të praktikuar fenë e tyre në mënyrë të ligjshme dhe u mundësonte të mbajnë disa kështjella dhe pozicione të armatosura për mbrojtjen e komuniteteve të tyre, duke u dhënë kështu një ndjesi sigurie fizike dhe politike.

Përveç sigurimit të të drejtave fetare, Edikti i Nantës krijoi një kornizë tolerance që ndihmoi në qetësimin e tensioneve shoqërore dhe politike. Ai uli konfliktet e përditshme midis komuniteteve dhe frenoi rebelimet lokale, duke i dhënë Francës mundësinë të stabilizohej pas një periudhe të gjatë trazirash dhe luftërash fetare. Edikti përfaqësoi një kompromis pragmatik: nuk garantonte një barazi të plotë fetare, por siguroi bashkëjetesën e mundshme midis besimeve të ndryshme dhe krijoi precedent për trajtimin e pakicave fetare në shek. XVII. Në këtë mënyrë, Henri IV arriti të përforconte autoritetin e tij, të mbante stabilitetin politik dhe të siguronte një nivel minimal paqeje dhe lirie fetare për popullsinë e kohës.

– **Pikat e përbashkëta:**

- Të dy ediktet, Edikti i Milanit (313) dhe Edikti i Nantës (1598), u shpallën për të siguruar paqen dhe lirinë fetare në shoqëri që ishin përfshirë nga konflikte të thella fetare. Në të dy rastet, sunduesit përdorën këto akte si mjet për të pakësuar tensionet midis grupeve fetare dhe për të krijuar një kuadër ligjor që lejonte praktikimin e lirë të besimit.
- Të dy ediktet shërbyen gjithashtu për të forcuar autoritetin e sunduesit, duke e pozicionuar atë si garant të paqes dhe të drejtave të qytetarëve, dhe për të ruajtur stabilitetin politik në një kohë krize ose pas luftërash.

- b) Interesi politik dhe ruajtja e pushtetit: Cilat elemente të dy edikteve tregojnë se sunduesit i përdorën ato si mjet për të ruajtur pushtetin dhe stabilitetin e shtetit? Evidentoni dy pika të përbashkëta midis këtyre dy edikteve.

4 pikë

- **Edikti i Milanit:** Perandori Konstandini i Madh nuk e nxori këtë edikt vetëm për të garantuar tolerancën fetare, por edhe për të siguruar mbështetjen e komunitetit në rritje të krishterë brenda Perandorisë Romake. Duke legalizuar krishterimin dhe duke u lejuar qytetarëve të krishterë të zotërojnë prona dhe të ndërtojnë institucione fetare, Konstandini forcoi legjitimitetin e tij moral dhe autoritetin politik. Edikti shërbeu për të ulur tensionet brenda perandorisë dhe për të parandaluar rebelime të mundshme nga një komunitet fetar që po fitonte gjithnjë e më shumë influencë. Në këtë mënyrë, toleranca fetare u përdor si një instrument për të stabilizuar Perandorinë dhe për të konsoliduar pushtetin e perandorit.
- **Edikti i Nantës:** Mbreti Henri IV e nxori ediktin pas dekadash të Luftërave Fetare (1562–1598), të cilat kishin shkatërruar Francën dhe kishin krijuar një situatë të brishtë politike. Duke u garantuar hygenotëve lirinë për të praktikuar fenë e tyre dhe të mbajnë disa pozicione të armatosura për mbrojtje, Henri IV arriti të reduktonte tensionet dhe të parandalojë rebelime që mund të minonin autoritetin mbretëror. Ky kompromis politik funksionoi si një mjet për të konsoliduar autoritetin e tij dhe për të ruajtur stabilitetin e Francës, duke kombinuar interesin fetar me nevojën për qeverisje efektive dhe kontroll politik.
- **Pikat e përbashkëta:**
 - Të dy sunduesit përdorën ediktet për të konsoliduar pushtetin e tyre dhe për të ruajtur stabilitetin politik, duke i dhënë një kuptim praktik tolerancës fetare.
 - Në të dy rastet, liria fetare u shfrytëzua si një mjet për të parandaluar rebelimet dhe për të garantuar unitetin e shtetit, duke transformuar tensionet fetare në një mekanizëm për forcimin e autoritetit politik të sunduesve.

- c) Vlerësim i përgjithshëm: Këto edikte ishin kryesisht për paqen dhe lirinë fetare apo për interes politik dhe stabilitet shtetëror? Jepni një mendim kritik mbi ndikimin afatgjatë të edikteve.

3 pikë

Ediktet historike, si Edikti i Milanit (313) dhe Edikti i Nantës (1598), nuk mund të kuptohen si dokumente thjesht idealiste ose vetëm shpirtërore. Ato ishin gjithmonë një kombinim i synimeve fetare dhe interesave politike, ku liria fetare shërbente shpesh si një mjet për ruajtjen e stabilitetit shtetëror dhe fuqisë së sunduesve.

Edikti i Milanit nuk kishte vetëm dimension fetar; duke legalizuar krishterimin; ai krijoi një precedent të rëndësishëm për tolerancën fetare dhe vendosi bazat për një marrëdhënie bashkëpunimi midis Kishës dhe Perandorisë Romake. Përveç kësaj, legalizimi i krishterimit i dha legjitimitet politik dhe moral Konstandinit të Madh, duke e forcuar autoritetin e tij përballë popullsisë dhe elitës. Kisha u fuqizua si partner politik, duke siguruar se ndikimi shpirtëror mund të përdorej edhe për të konsoliduar pushtetin laik.

Në rastin e Ediktit të Nantës, qëllimi kryesor ishte menaxhimi i tensioneve fetare midis katolikëve dhe hygenotëve pas një periudhe të gjatë luftërash civile në Francë. Edikti ofronte liri të kufizuar për hygenotët për të praktikuar besimin e tyre dhe të mbajnë disa pozicione të armatosura, duke ruajtur paqen relative dhe stabilitetin politik. Megjithatë, anulimi i tij në 1685 nga Luigji XIV tregon qartë se interesi politik i mbretit shpesh mbivendosej mbi tolerancën fetare, duke e bërë tolerancën fetare të ndërlikuar dhe të pasigurt afatgjatë.

Përfundimisht, këto edikte tregojnë se paqja dhe liria fetare në histori kanë qenë gjithmonë të lidhura ngushtë me strategjitë politike dhe ruajtjen e pushtetit. Ato reflektojnë tensionin e vazhdueshëm midis idealeve humaniste, si respekti për besimin dhe individin, dhe realitetit politik, ku sunduesit shpesh duhet të balancojnë fuqinë, stabilitetin dhe kontrollin mbi shoqërinë.

Mendimi kritik: Ediktet nuk ishin vetëm instrumente ligjore ose shpirtërore; ato ishin gjithashtu mjet strategjik për menaxhimin e shoqërisë, duke pasqyruar kompleksitetin e politikës fetare dhe të pushtetit në historinë evropiane. Ky kombinim i shpirtërores dhe politikës është ajo që bën ediktet si të Milanit ashtu edhe të Nantës të studiara dhe të vlerësuara edhe sot si shembuj të marrëdhënieve komplekse midis fesë, ligjit dhe pushtetit.

2. Pasi të lexoni dokumentet e mëposhtme përgjigjuni pyetjes.

Dokumenti 1

"Kongresi deklaroi se mirëqenia e përgjithshme kërkon krijimin e një sistemi për përfitimet federale të pleqërisë dhe krijimin e një programi të kompensimit të papunësisë për ta mbrojtur nga rreziqet dhe pasiguritë e jetës."

Akti i Sigurimeve Shoqërore i SHBA-së (1935)

Dokumenti 2

"Shteti duhet të ofrojë siguri për të gjithë kundër pesë gjigantëve: varfërisë, sëmundjes, paditurisë, mjerimit dhe papunësisë. Sigurimi shoqëror duhet të jetë gjithëpërfshirës, universal dhe i mjaftueshëm."

"Raporti Beveridge" (Britania e Madhe, 1942)

Dokumenti 3

"Ne duhet të krijojmë një shërbim shëndetësor kombëtar dhe të sigurojmë që çdo qytetar të ketë akses në kujdesin mjekësor, pavarësisht nga mjetet. Kjo nuk është bamirësi, por një e drejtë e qytetarisë."

Winston Churchill, Fjalimi mbi Sigurimet Shoqërore (1943)

Dokumenti 4

"Shteti duhet të garantojë sigurinë e çdo qytetari nga djepi në varr. Politika sociale duhet të përfshijë kujdesin shëndetësor universal, pensionet, sigurimin e papunësisë dhe ndihmat familjare, të financuara përmes taksimit progresiv. Barazia nuk është bamirësi, por themeli i demokracisë."

Programi i Partisë Social Demokrate Suedeze (1932)

Dokumenti 5

"Kombi u garanton të gjithëve, veçanërisht fëmijëve, nënave dhe punëtorëve të moshuar, mbrojtjen e shëndetit, sigurinë materiale, pushimin dhe kohën e lirë. Çdo qenie njerëzore që, për shkak të moshës, gjendjes fizike ose situatës ekonomike, nuk është në gjendje të punojë, ka të drejtë të marrë mjete të përshtatshme jetese nga komuniteti."

Kushtetuta e Republikës IV Franceze (1946)

Krahasoni "New Deal" amerikan të viteve 1930 me zhvillimin e modeleve evropiane të shtetit të mirëqenies sociale në shekullin XX. Në përgjigjen tuaj, argumentoni në çfarë mase secili sistem adresoi pasigurinë ekonomike, pabarazinë sociale dhe rolin e qeverisë në jetën e qytetarëve. Jepni tre përfundime krahasuese.

a) Adresimi i pasigurisë ekonomike

2 pikë

- **"New Deal" (SHBA)** u zhvillua si një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj krizës së thellë gjatë Depresionit të Madh, e cila solli papunësi masive dhe varfëri të përhapur. Qeveria ndërhyri për të stabilizuar ekonominë dhe për të ofruar mbështetje për shtetasit më të prekura, duke krijuar programe punësimi dhe duke vendosur bazat e sigurimeve shoqërore për të moshuarit dhe të papunët. Këto masa shënuan një ndryshim të rëndësishëm në rolin e shtetit amerikan, duke kaluar nga një rol minimal në një rol më aktiv në mbrojtjen sociale. Megjithatë, sistemi mbeti i kufizuar në shtrirje dhe nuk ishte universal; shumë qytetarë nuk përfshiheshin në skemat e mbrojtjes. Në këtë kuptim, "New Deal"-i synonte më shumë të lehtësonte krizën ekonomike sesa të krijonte një sistem të plotë dhe afatgjatë sigurie për të gjithë popullsinë.
- **Modelet evropiane të shtetit të mirëqenies** - Në Evropë, zhvillimi i shtetit të mirëqenies kishte një qasje më të gjerë dhe më sistematike ndaj pasigurisë ekonomike. I ndikuar nga ide si ato të paraqitura në Raporti Beveridge, ky model synonte të garantonte mbrojtje për të gjithë qytetarët pa përjashtim. Shteti mori përgjegjësi për të luftuar jo vetëm papunësinë, por edhe varfërinë, sëmundjen dhe mungesën e arsimit, duke krijuar një rrjet të plotë sigurie sociale. Kjo u realizua përmes sistemeve universale të pensioneve, sigurimit të papunësisë dhe kujdesit shëndetësor, të cilat ofroheshin si të drejta qytetare dhe jo si ndihmë e përkohshme. Në thelb, modeli evropian synonte të siguronte stabilitet afatgjatë dhe mbrojtje të vazhdueshme "nga djepi në varr", duke e bërë atë më gjithëpërfshirës dhe më të qëndrueshëm krahasuar me qasjen amerikane.

b) Pabarazia sociale

2 pikë

- **“New Deal” (SHBA)** kontribuoi ndjeshëm në zbutjen e pasojave më të rënda të krizës së Depresionit të Madh, duke ulur nivelin e varfërisë dhe duke krijuar mundësi punësimi për shumë qytetarë. Përmes programeve sociale dhe ndërhyrjes shtetërore, ai ndihmoi në stabilizimin e jetës ekonomike të shtresave më të prekura. Megjithatë, këto politika nuk synonin një transformim të thellë të strukturës shoqërore. Pabarazitë midis grupeve të ndryshme – si ato ekonomike apo rajonale – vazhduan të ekzistonin, pasi reformat ishin të kufizuara dhe nuk preknin rrënjësisht shpërndarjen e pasurisë. Në thelb, “New Deal”-i kishte një karakter më shumë reformues: ai lehtësoi gjendjen ekzistuese, por nuk krijoi një sistem të plotë barazie sociale.
- **Modelet evropiane të shtetit të mirëqenies** - Në Evropë, shteti i mirëqenies u ndërtua mbi një filozofi më të thellë barazie sociale. Ndryshe nga qasja amerikane, këto modele synonin drejtpërdrejt reduktimin e pabarazive midis shtresave të ndryshme të shoqërisë. Përmes politikave të tilla si taksimi progresiv dhe ofrimi i shërbimeve universale, arsimit, kujdesi shëndetësor dhe sigurimet shoqërore, shteti ndërhynte aktivisht për të rishpërndarë burimet dhe për të garantuar mundësi më të barabarta për të gjithë qytetarët. Siç theksohet në dokumentet përkatëse, barazia nuk shihej thjesht si ndihmë për të varfrit, por si një parim themelor i demokracisë dhe i drejtësisë sociale. Kjo e bëri modelin evropian më transformues, pasi synonte jo vetëm lehtësimin e varfërisë, por edhe ngushtimin e hendekut social në mënyrë të qëndrueshme.

c) Roli i qeverisë në jetën e qytetarëve

2 pikë

- **“New Deal” (SHBA)** përfaqësoi një kthesë të rëndësishme në mënyrën se si shteti ndërhynte në jetën ekonomike dhe sociale të qytetarëve. Deri në atë periudhë, roli i qeverisë kishte qenë relativisht i kufizuar, por kriza e Depresionit të Madh e detyroi shtetin të marrë një rol më aktiv. Qeveria filloi të ndërhyjë në rregullimin e tregut, në mbështetjen e sektorëve ekonomikë dhe në krijimin e programeve të ndihmës sociale për të papunët dhe të moshuarit. Kjo ndërhyrje shënoi një ndryshim të madh në raportin midis shtetit dhe qytetarit, duke e bërë shtetin një faktor kyç në garantimin e një minimumi sigurie ekonomike. Megjithatë, ky rol i zgjeruar kishte kufijtë e vet: ai mbeti brenda kornizës së një sistemi kapitalist liberal, ku iniciativa private dhe tregu i lirë vazhduan të ishin elementët kryesorë. Shteti nuk mori përgjegjësi të plotë për mirëqenien e çdo qytetari, por ndërhyri kryesisht për të stabilizuar sistemin dhe për të lehtësuar krizat.
- **Modelet evropiane të shtetit të mirëqenies** - Në Evropë, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, roli i qeverisë në jetën e qytetarëve u zgjerua në mënyrë shumë më të thellë dhe më të qëndrueshme. Shteti nuk u kufizua vetëm në ndërhyrje ekonomike apo në masa të përkohshme, por mori përgjegjësi të drejtpërdrejta për mirëqenien sociale të gjithë popullsisë. Kjo përfshinte krijimin e sistemeve universale të kujdesit shëndetësor, pensioneve, sigurimeve të papunësisë dhe ndihmave sociale, të cilat synonin të garantonin një standard jetese dinjitoze për çdo qytetar. Ndryshe nga qasja amerikane, këto shërbime nuk konsideroheshin si ndihmë e përkohshme apo bamirësi, por si të drejta themelore të qytetarisë, siç theksohet edhe në dokumentet përkatëse. Në këtë mënyrë, shteti evropian u bë një aktor qendror në organizimin e jetës sociale dhe ekonomike, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe në reduktimin e pasigurive. Ky model përfaqësonte një nivel shumë më të lartë ndërhyrjeje dhe përgjegjësie shtetërore krahasuar me atë të “New Deal”-it.

d) Përfundime krahasuese

3 pikë

- *Së pari*, “New Deal” në SHBA ishte një hap i rëndësishëm drejt mbrojtjes sociale dhe ndërhyrjes së shtetit për të përballuar krizën ekonomike, ndërsa modelet e shtetit të mirëqenies në Evropë u ndërtuan si sisteme më të gjera dhe më të plota, që synonin mbrojtje universale për të gjithë qytetarët.
- *Së dyti*, “New Deal” ndihmoi në lehtësimin e varfërisë dhe papunësisë, por mbeti i kufizuar dhe nuk arriti të zhdukë pabarazitë strukturore, ndërsa modelet evropiane të shtetit të mirëqenies ishin më të orientuara drejt barazisë sociale, duke përdorur politika rishpërndarëse dhe shërbime universale për të ngushtuar hendekun midis shtresave.
- *Së treti*, “New Deal” përfaqësonte kryesisht një reagim ndaj një krize të menjëhershme si Depresioni i Madh, ndërsa modelet e shtetit të mirëqenies në Evropë, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, u zhvilluan si sisteme afatgjata dhe të qëndrueshme që garantonin mirëqenie dhe siguri sociale për qytetarët gjatë gjithë jetës.

3. Në gjysmën e dytë të viteve 1980 kriza ekonomike, që kishte përfshirë vendet ballkanike të sunduara nga partitë komuniste, u thellua edhe më tepër. Ajo filloi të shndërrohej në një krizë të përgjithshme, duke përfshirë edhe fushat politike dhe sociale. Gjendja e popullsisë po bëhej gjithnjë e më e rëndë. Regjimet komuniste në këto vende u munduan të ruanin sundimin e tyre duke ndërmarrë disa “reforma” gjysmake. Por, ato ishin sipërfaqësore dhe nuk preknin bazat e sistemit politik të këtyre vendeve, prandaj ishin të prirura të dështonin.

Rumania, Bullgaria e Shqipëria u përfshinë nga ndryshimet me karakter demokratik pas vitit 1990. I vetmi vend i cili i rezistoi edhe për disa vjet këtyre ndryshimeve ishte Jugosllavia.

- a) Organizimi federativ dhe stabiliteti politik. Analizoni si ndikoi struktura federative e Jugosllavisë në aftësinë e regjimit për të shtypur kërkesat për demokratizim gjatë viteve 1980. Jepni një shembull të tensionit midis republikave që demonstrojnë përdorimin e federatës si instrument kontrolli politik. **2 pikë**

Struktura federative e Jugosllavisë ndikoi në aftësinë e regjimit për të shtypur kërkesat për demokratizim, sepse pushteti ishte i ndarë midis shteteve anëtare dhe provincave autonome, gjë që krijonte mekanizma kontrolli të ndërlikuar dhe mundësi për balancim të interesave. Kjo ndarje lejonte Partinë Komuniste dhe udhëheqësit federalë të përdornin rivalitetet dhe tensionet midis republikave për të ruajtur stabilitetin dhe për të vonuar ndryshimet politike.

Shembull konkret: Në fund të viteve 1980, tensionet midis Serbisë dhe Kroacisë, për shkak të kërkesave për më shumë autonomi dhe përfaqësim politik, u menaxhuan nga udhëheqësit federalë duke ndërmjetësuar kompromise administrative dhe duke përdorur mekanizmat federativ për të shpërndarë pushtetin politik, duke ruajtur kështu unitetin e shtetit dhe duke vonuar demokratizimin e plotë.

Çdo shembull tjetër i dhënë nga nxënësi, që gjykohet si i saktë.

- b) Diferencat ekonomike rajonale. Identifikoni republikën më të zhvilluar dhe atë më pak të zhvilluar në Jugosllavi dhe analizoni ndikimin e kësaj pabarazie në politikën federale dhe rezistencën ndaj reformave. Analizoni ndryshimet në pasojat e krizës ekonomike midis republikave të Jugosllavisë dhe diskutoni se si këto ndryshime ndikuan në qëndrueshmërinë politike dhe stabilitetin e regjimit federativ. **2 pikë**

Në Jugosllavi, Sllovenia ishte republika më e zhvilluar ekonomikisht, me industri të avancuar dhe nivel jetese më të lartë, ndërsa Maqedonia dhe disa rajone të Bosnjës dhe Kosovës konsideroheshin më pak të zhvilluara, me ekonomi më të dobët dhe më pak mundësi punësimi. Kjo pabarazi ekonomike krijoi tensione brenda federatës, pasi republikat më të zhvilluara ndiheshin të ngarkuara për të mbështetur ato më të varfra, ndërsa këto të fundit kërkonin më shumë fonde dhe autonomi për zhvillim.

Ndikimi i krizës ekonomike ishte i ndryshëm mes republikave: në rajonet më të zhvilluara, popullsia përjetoj ngadalësim të rritjes dhe rritje të papunësisë, por sistemi ekonomik arriti të ofronte mbështetje relative; ndërsa në rajonet më të varfra, kriza shkaktoi vështirësi më të mëdha, ulje të standardit të jetesës dhe tensione sociale.

Këto dallime ekonomikisht të theksuara ndikuan në qëndrueshmërinë e regjimit, sepse udhëheqësit federalë përdornin mekanizma federativ dhe ndërmjetësime për të balancuar interesat e republikave dhe për të vonuar kërkesat për reforma demokratike. Megjithatë, pabarazitë rritën mosmarrëveshjet dhe krijuan baza për tensione të ardhshme që do të minonin unitetin federal.

- c) Roli i Ushtrisë Popullore Jugosllave (JNA). Analizoni rolin e JNA-së në kontrollin e tensioneve politike dhe etnike. Krahasoni rolin e JNA-së me atë të ushtrive të vendeve fqinje komuniste në mbajtjen e regjimit. **2 pikë**

Ushtria Popullore Jugosllave (JNA) luajti një rol kyç në kontrollin e tensioneve politike dhe etnike gjatë viteve 1980, duke vepruar si garant i unitetit federal dhe mbështetje për Partinë Komuniste. Struktura e saj hierarkike dhe përbërja multietnike e ushtrisë i mundësonin udhëheqësve federalë të ndërhyjnë në konflikte ndërmjet republikave dhe të shtypnin lëvizjet për autonomi që mund të kërcënonin stabilitetin e shtetit. Ushtria përdorte gjithashtu një kombinim të pranisë fizike, kërcënimeve dhe ndërmjetësimeve politike për të ruajtur rendin dhe kontrollin mbi federatën.

Në krahasim me ushtritë e vendeve fqinje komuniste, si Rumania, Bullgaria apo Shqipëria, JNA kishte një rol më kompleks dhe më integrues. Ndërsa ushtritë e këtyre vendeve shërbenin kryesisht për të mbrojtur regjimin qendror dhe për të shtypur çdo sfidë politike brenda një shteti homogjen, JNA duhej të menaxhonte edhe dallimet etnike dhe autonominë brenda federatës. Kjo e bënte rolin e saj më të sofistikuar, por gjithashtu më të ndërlikuar dhe me kufizime, pasi ndërhyrjet ushtarake shpesh ishin të kufizuara nga nevoja për të ruajtur balancimin midis republikave dhe për të mos provokuar rebelime të hapura

- d) Identitetet etnike dhe politika e brendshme. Identifikoni dy grupe etnike që kishin tensione të forta brenda Jugosllavisë dhe shpjegoni strategjitë që përdorën udhëheqësit për të menaxhuar këto tensione. Diskutoni nëse këto strategji ishin afatshkurtra apo afatgjata dhe pse. **2 pikë**

Brenda Jugosllavisë, tensionet më të forta etnike ndodhën midis serbëve dhe kroatëve, si dhe midis serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Në konfliktet midis këtyre grupeve përfshiheshin kërkesat për autonomi, përfaqësim politik dhe kontroll mbi burime ekonomike.

Udhëheqësit jugosllavë përdorën disa strategji për të menaxhuar këto tensione:

- Balancimi politik: Ndërmjetësime dhe kompromis midis republika dhe provincave autonome për ndarjen e pushtetit në institucionet federale.
- Roli i JNA: Përdorimi i ushtrisë si forcë për të frikësuar ose parandaluar shpërthimin e dhunës etnike.
- Decentralizimi i kontrollit: Disa kompetenca lokale iu dhanë republikave dhe provincave për të menaxhuar çështje të brendshme, duke ulur presionin mbi qeverinë qendrore.

Këto strategji ishin kryesisht afatshkurtra, sepse megjithëse arritën të vononin konfliktet dhe të ruanin stabilitetin relativ për disa vite, ato nuk adresuan problemet themelore të rivalitetit etnik dhe diferencave ekonomike. Për këtë arsye, tensionet u rritën gradualisht dhe, pas rënies së regjimit, dolën në konflikte të hapura në fillim të viteve 1990.

- e) Modeli ekonomik dhe ndikimi në krizë. Analizoni rolin e vetë-menaxhimit të punëtorëve dhe të decentralizimit ekonomik në aftësinë e Jugosllavisë për të përballuar krizën e viteve 1980. Jepni një vlerësim kritik të marrëdhënies midis strukturës ekonomike dhe politikës federale në kontekstin e stabilitetit dhe vonësës së demokratizimit. **2 pikë**

Në Jugosllavi, vetë-menaxhimi i punëtorëve dhe decentralizimi ekonomik ishin tipare kryesore të sistemit socialist, që u mundësuan fabrikave dhe ndërmarrjeve të menaxhojnë pjesërisht veprimtaritë e tyre dhe të vendosin për shpërndarjen e fitimeve. Kjo strukturë lehtësoi përballimin afatshkurtër të krizës së viteve 1980, sepse punëtorët dhe menaxherët lokalë mundën të adaptonin aktivitetet ekonomike sipas kushteve rajonale, duke zvogëluar mosfunksionim e menjëhershme të sistemit.

Megjithatë, decentralizimi i fuqisë ekonomike krijoi dobësi strukturore, pasi qeveria federale kishte kontroll të kufizuar mbi ekonominë dhe nuk mund të ndërhynte me politika të unifikuara për të stabilizuar të gjitha republikat njëkohësisht. Kjo kontribuoi në mosbalancimin ekonomik midis rajoneve, duke theksuar pabarazitë mes republikave më të zhvilluara dhe më pak të zhvilluara.

Nga një vlerësim kritik, marrëdhënia midis strukturës ekonomike dhe politikës federale tregoi se decentralizimi ndihmoi në vonësën e rënies së regjimit, sepse zbuti disa presione sociale dhe politike, por nuk arriti të zgjidhte problemet themelore të krizës. Në thelb, modeli ekonomik e mbajti Jugosllavinë funksionale për disa vite, por nuk mundësoi një reformë të qëndrueshme demokratike, pasi pabarazitë dhe tensionet midis republikave vazhduan të rriteshin gradualisht.

4. Pasi të lexoni dokumentet e mëposhtme përgjigjuni pyetjes.

Dokumenti 1

"Ne do të përpiqemi të fitojmë sovranitet mbi një copë tokë mjaftueshëm të madhe për të përmbushur kërkesat e ligjshme të një kombi. Palestina është atdheu ynë historik i paharrueshëm."

Theodor Herzl, Shteti Hebraik (1896)

Dokumenti 2

"Qeveria e Madhërisë së Tij e sheh me sy të mirë krijimin në Palestinë të një shtëpie kombëtare për popullin hebre dhe do të bëjë çmos për të lehtësuar arritjen e këtij objekti, duke u kuptuar qartë se nuk do të bëhet asgjë që mund të cenojë të drejtat civile dhe fetare të komuniteteve ekzistuese jo-hebraike në Palestinë."

Deklarata e Balfourit (1917)

Dokumenti 3

"Shtetet e Pavarura Arabe dhe Hebraike dhe Regjimi Ndërkombëtar Special për Qytetin e Jerusalemit do të krijohen në Palestinë."

Plani i Ndarjes së OKB-së (Rezoluta 181, 1947)

Dokumenti 4

"Ne ikëm nga fshati ynë kur filluan luftimet. Mendonim se do të ktheheshim pas disa ditësh, por ditët u bënë vite. Shtëpitë tona janë zhdukur dhe jetojmë në kampe pa të drejta."

Dëshmia e një refugjatit palestinez (1967), pas Luftës Gjashtëditore

Dokumenti 5

"Krijimi i një shteti palestinez përmes luftës dhe vetëvendosjes."

Karta e Organizatës për Çlirimin e Palestinës (1964)

Dokumenti 6

"Njohja reciproke midis Izraelit dhe PLO-së dhe krijimi i një procesi për paqe."

Marrëveshja e Oslos (1993)

Vlerësoni shkaqet historike dhe politike të konfliktit midis palestinezëve dhe hebrenjve në shekullin XX dhe XXI. Në përgjigjen tuaj, analizoni natyrën dhe ecurinë e konfliktit dhe vlerësoni tri zgjidhje të mundshme për arritjen e paqes, duke diskutuar avantazhet dhe kufizimet e secilës.

a) Shkaqet historike dhe politike të konfliktit

2 pikë

Konflikti hebreo-palestinez i ka rrënjët e tij që në fund të shekullit XIX, kur lëvizja sioniste e udhëhequr nga Theodor Herzl (Dokumenti 1) synonte krijimin e një shteti hebraik në Palestinë, të cilin e konsideronte atdheu historik të popullit hebre. Kjo ide përplasej me realitetin e banorëve arabë që jetonin në të njëjtin territor prej shekujsh, duke krijuar tension për tokën, pronën dhe resurse të tjera jetësore. Shkaqet historike lidhen me dëshirën për vetëvendosje kombëtare të dy popujve dhe me përkatësinë e tyre ndaj territorit.

Në aspektin politik, Deklarata e Balfourit (1917) (Dokumenti 2) dhe politika britanike favorizuan krijimin e një shtëpie kombëtare hebre, duke lënë të paqartë të drejtat e komuniteteve arabe. Kjo ndërhyrje ndërkombëtare e institucionalizoi tensionin dhe vendosi bazën për përplasje të vazhdueshme. Më vonë, Plani i Ndarjes së OKB-së (1947), (Dokumenti 3) propozoi një zgjidhje territoriale për dy shtete, por u refuzua nga shumica e palestinezëve, duke intensifikuar konfliktin dhe çuar në luftën e vitit 1948.

b) Natyrë dhe ecuria e konfliktit

2 pikë

Konflikti ka një karakter territorial, identitar dhe religjioz, pasi përfshin tokën, të drejtën për vetëvendosje dhe të drejtat e qytetarisë për dy komunitete me besime dhe histori të ndryshme. Lufta e vitit 1948 rezultoi në krijimin e shtetit të Izraelit dhe shpërnguljen masive të palestinezëve, të cilët u bënë refugjatë dhe humbën tokat dhe shtëpitë e tyre (Dokumenti 4).

Në dekadat e mëvonshme, Organizata për Çlirimin e Palestinës (PLO, Dokumenti 5) promovoi luftën dhe vetëvendosjen si mjete për krijimin e një shteti palestinez, duke theksuar natyrën e konfliktit si të pazgjidhur dhe të vazhdueshëm. Megjithatë, procesi i Oslos (1993, Dokumenti 6) tregoi përpjekjet për dialog dhe njohje reciproke, duke hapur një rrugë për zgjidhje paqësore, por sfidat praktike, mosbesimi dhe dhuna periodike penguan arritjen e një marrëveshjeje të qëndrueshme.

- c) Zgjidhjet e mundshme për paqe dhe vlerësimi i tyre, avantazhet dhe kufizimet. **6 pikë**
- Krijimi i një shteti të dyfishtë
 Avantazhet: Siguron njohje reciproke, autonomi të qartë për palestinezët dhe stabilitet për Izraelin. Krijon një bazë ligjore për zgjidhjen e çështjes së refugjatëve dhe sigurisë.
 Kufizimet: Ndërhyrjet territoriale, kufijtë e diskutueshëm dhe ndarja e Jerusalemit mbeten pengesa të mëdha. Disa komunitete ekstremiste nuk pranojnë kompromiset, duke vënë në rrezik stabilitetin.
 - Krijimi i një shteti të vetëm
 Avantazhet: Siguron barazi ligjore për të gjithë banorët dhe zgjidhje të çështjeve të qytetësisë dhe refugjatëve. Mund të eliminonte nevojën për ndarje territoriale.
 Kufizimet: Rrit tensionet etnike dhe rrezikon të shkatërrojë identitetin kombëtar të një prej palëve. Përballja me mosmarrëveshjet historike dhe tensionet fetare është shumë e vështirë.
 - Dialog gradual dhe marrëveshje reciproke
 Avantazhet: Ofron rrugë për bashkëpunim ekonomik, politik dhe të sigurisë, duke krijuar besim të pjesshëm midis palëve.
 Kufizimet: Kërkon besim të qëndrueshëm dhe zbatim të detyrueshëm nga të dyja palët; shpesh pengohet nga dhuna dhe përçarjet brenda palëve.

5. Lexoni dokumentet e mëposhtme.

Dokumenti 1

“Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tij, çdo njeri i nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve që përcaktohen me ligj, me qëllim sigurimin e njohjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe për të përmbushur kërkesat e drejta të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme.”

Neni 29; Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948), OKB

Dokumenti 2

Pas sulmeve të 11 shtatorit 2001, qeveria e SHBA miratoi ligjin Patriot Act, i cili zgjeroi kompetencat e survejimit dhe ndalimit në emër të luftës kundër terrorizmit.

Dokumenti 3

Në disa vende të Bashkimit Evropian, gjatë krizave të sigurisë (terrorizëm, pandemi), janë vendosur masa të jashtëzakonshme si kufizimi i lëvizjes, monitorimi digjital dhe ndalimi i tubimeve publike.

- a) Analizoni konceptin e kufizimit të të drejtave sipas Dokumentit 1. **2 pikë**

Dokumenti 1, i nxjerrë nga OKB, thekson se të drejtat e njeriut nuk janë absolute, por mund të kufizohen vetëm në bazë të ligjit dhe për qëllime të përcaktuara qartë, si rendi publik dhe mirëqenia e përgjithshme. Ky formulim vendos disa parime thelbësore që përbëjnë bazën e çdo sistemi demokratik: ligjshmërinë, nevojshmërinë dhe proporcionalitetin.

Parimi i ligjshmërisë nënkupton që çdo kufizim duhet të jetë i parashikuar në ligj dhe jo rezultat i vendimeve arbitrare të autoriteteve. Kjo siguron transparencë dhe parandalon abuzimin me pushtetin, pasi qytetarët duhet të jenë të informuar për kufijtë e të drejtave të tyre.

Parimi i nevojshmërisë kërkon që kufizimi të vendoset vetëm kur është realisht i domosdoshëm për mbrojtjen e një interesi legjitim, si siguria publike apo të drejtat e të tjerëve. Kjo do të thotë se shteti nuk duhet të ndërhyjë në mënyrë të panevojshme ose të ekzagjeruar.

Ndërsa parimi i proporcionalitetit kërkon një ekuilibër të kujdesshëm midis masës kufizuese dhe qëllimit që synohet të arrihet. Kufizimi nuk duhet të jetë më i rëndë sesa kërkon situata dhe duhet të prekë sa më pak të jetë e mundur thelbin e të drejtave themelore.

Përtej këtyre, ky nen nënkupton edhe parime të tjera të rëndësishme, si mosdiskriminimi dhe përkohshmëria e kufizimeve. Çdo masë duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë dhe të mos shndërrohet në një praktikë të përhershme.

Në këtë kuptim, dokumenti vendos një ekuilibër delikat midis lirisë individuale dhe interesit kolektiv. Ai pranon se në një shoqëri demokratike, liritë nuk mund të jenë të pakufizuara, por njëkohësisht vendos kufij të qartë për shtetin, duke garantuar që çdo ndërhyrje të jetë e justifikuar, e kontrolluar dhe në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës.

- b) Duke u mbështetur tek dokumenti 2 dhe 3, krahasoni masat e marra në SHBA pas vitit 2001 me ato në vendet e Bashkimi Evropian. Identifikoni dhe analizoni tre ngjashmëri dhe tre dallime në qasje. Jepni një vlerësim kritik.

3 pikë

– **Ngjashmëritë në qasje**

Së pari, të dyja palët rritën ndjeshëm kompetencat e shtetit në fushën e sigurisë. U zgjerua survejimi i komunikimeve, u forcuan shërbimet e inteligjencës dhe u rrit bashkëpunimi ndërinstitucional për parandalimin e terrorizmit.

Së dyti, si në SHBA ashtu edhe në BE, u miratuan ligje të reja që kufizonin disa të drejta individuale, veçanërisht privatësinë dhe lirinë e lëvizjes, me argumentin e mbrojtjes së jetës dhe sigurisë publike.

Së treti, të dyja rastet tregojnë një tendencë të zgjerimit të rolit të shtetit në situata krize, duke e vendosur sigurinë si prioritet të menjëhershëm.

– **Dallimet në qasje**

Së pari, në Shtetet e Bashkuara, qasja ishte më e centralizuar dhe më agresive. Ligje si Patriot Act i dhanë autoriteteve kompetenca shumë të gjera për survejim dhe ndalim, shpesh me kontroll të kufizuar gjyqësor në fazat fillestare. Prioriteti kryesor ishte parandalimi i menjëhershëm i çdo kërcënimi, edhe nëse kjo sillte kufizime më të theksuara të lirive civile.

Në kontrast, vendet e Bashkimi Evropian operojnë brenda një sistemi më kompleks juridik, ku një rol të rëndësishëm luajnë gjykatat dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kjo ka bërë që masat të jenë më të kontrolluara dhe më të kufizuara në kohë, të paktën në nivel formal. Gjithashtu, në BE ekziston një theks më i madh mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtave themelore.

Së dyti, SHBA si shtet i vetëm vepron më shpejt dhe më në mënyrë uniforme, ndërsa BE përbëhet nga shtete të ndryshme, çka sjell qasje të ndryshme dhe ndonjëherë më pak koherencë në zbatim.

Së treti, në Shtetet e Bashkuara, shumë programe sigurie, sidomos ato të survejimit, janë zhvilluar fillimisht në mënyrë sekrete dhe janë bërë objekt debati publik vetëm pas zbulimeve apo skandaleve. Kjo ka treguar një prirje për të vepruar me diskrecion të lartë në emër të sigurisë kombëtare, duke e kufizuar në fazat e para mbikëqyrjen demokratike.

Në të kundërt, në vendet e Bashkimi Evropian ekziston një presion më i madh për transparencë dhe përfshirje të institucioneve të pavarura, si gjykatat kushtetuese dhe autoritetet për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo nuk do të thotë se mungojnë problemet, por në përgjithësi masat e sigurisë në BE janë më të ekspozuara ndaj debatit publik dhe kontrollit institucional, çka krijon më shumë mekanizma për të kufizuar abuzimet.

– **Vlerësim kritik**

Si Shtetet e Bashkuara, ashtu edhe Bashkimi Evropian ndajnë qëllimin e përbashkët për garantimin e sigurisë, mënyra se si e balancojnë atë me të drejtat e njeriut ndryshon. SHBA priret drejt një modeli më të fortë sigurie, ndërsa BE synon një ekuilibër më të theksuar midis sigurisë dhe lirive themelore, edhe pse në praktikë ky ekuilibër shpesh vihet në provë.

- c) A mund të përdoret koncepti i “sigurisë kombëtare” si justifikim për shkelje sistematike të të drejtave të njeriut? Jepni një shembull.

3 pikë

Po, koncepti i “sigurisë kombëtare” mund të përdoret si justifikim për shkelje sistematike të të drejtave të njeriut, veçanërisht kur mungojnë mekanizmat e kontrollit demokratik dhe transparencë. Në teori, siguria kombëtare është një qëllim legjitim i shtetit, por në praktikë ajo shpesh është përdorur si një koncept i gjerë dhe i paqartë për të legjitimuar masa represive.

Siguria kombëtare mund të jetë një nevojë reale, por kur përdoret pa kufij të qartë ligjorë dhe pa kontroll institucional, ajo kthehet në një mjet për shkelje sistematike të të drejtave të njeriut. Prandaj, është thelbësore që çdo masë e tillë të kufizohet nga parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe respektimit të dinjitetit njerëzor.

Një shembull i qartë historik është Gjermania naziste nën udhëheqjen e Adolf Hitler, ku në emër të “sigurisë së shtetit” u justifikuan persekutimet, ndalimet arbitrare dhe eliminimi i kundërshtarëve politikë, duke çuar në shkelje masive të të drejtave të njeriut.

Një tjetër rast është Bashkimi Sovjetik gjatë regjimit të Joseph Stalin, ku koncepti i mbrojtjes së shtetit përdorej për të justifikuar spastrime politike, burgosje masive dhe kontroll të plotë mbi shoqërinë.

Edhe në kohë më moderne, pas sulmeve të 11 shtatorit 2001, Shtetet e Bashkuara ndërmorën masa të forta sigurie që në disa raste janë kritikuar për shkelje të të drejtave, si ndalimet pa gjyq të plotë apo përdorimi i

teknikave të ashpra në marrje në pyetje. Edhe pse këto nuk përbëjnë një sistem shtypjeje të krahasueshëm me regjimet totalitare, ato tregojnë se edhe demokracitë mund të tejkalojnë kufijtë në emër të sigurisë.

d) Analizoni rolin e teknologjisë në rritjen e tensionit midis sigurisë dhe privatësisë.

2 pikë

Teknologjia ka luajtur një rol vendimtar në rritjen e tensionit midis sigurisë dhe privatësisë, duke krijuar një balancë gjithnjë e më të vështirë midis mbrojtjes së qytetarëve dhe respektimit të lirive individuale. Nga njëra anë, ajo ka rritur ndjeshëm kapacitetet e shteteve për të parandaluar krime dhe kërcënime, por nga ana tjetër ka zgjeruar mundësitë për mbikëqyrje masive.

Së pari, zhvillimi i mjeteve tëurvejimit digjital, si monitorimi i komunikimeve, analizimi i të dhënave dhe përdorimi i inteligjencës artificiale, u ka dhënë autoriteteve mundësinë të identifikojnë rreziqe potenciale në kohë reale. Për shembull, pas sulmeve të 11 shtatorit 2001, shumë shtete, përfshirë Shtetet e Bashkuara, zgjeruan programet e mbikëqyrjes për të parandaluar terrorizmin. Këto masa kanë kontribuar në rritjen e sigurisë, por kanë ngritur shqetësime serioze për cenimin e privatësisë së qytetarëve.

Së dyti, teknologjia ka bërë të mundur mbledhjen dhe ruajtjen masive të të dhënave personale, shpesh pa dijeninë e individëve. Kjo përfshin të dhëna mbi komunikimet, vendndodhjen, aktivitetin online dhe sjelljen sociale. Në këtë kontekst, kufiri midis sigurisë dhe kontrollit bëhet i paqartë, pasi mbikëqyrja mund të kalojë lehtësisht në abuzim.

Së treti, në vende të ndryshme, përdorimi i teknologjisë për siguri është shoqëruar me rrezikun e profilizimit dhe diskriminimit, ku individë apo grupe të caktuara mund të monitorohen më shumë se të tjerët. Kjo bie ndesh me parimet e barazisë dhe të drejtave themelore.

Nga ana tjetër, teknologjia nuk është vetëm kërcënim, por edhe një mjet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ajo mund të rrisë transparencën (p.sh. përmes publikimit të informacionit), të ndihmojë në dokumentimin e shkeljeve dhe të fuqizojë qytetarët për të kërkuar llogari nga institucionet.